

## **Veprime për Qëndrueshmërinë e Turizmit në Adriatik.**

### **Interreg III A – Adriatic Crossborder**



## **Kapaciteti i Mbajtjes Turistike të qytetit të Sarandës**

### **Përmbledhje**

Bashkepunetoret:  
**Giuseppe Michelangeli**  
**Stefano Sampaolesi**  
**Alessio Satta**

## Përmbajtje

<b>1 Parathënie-----</b>	<b>3</b>
<b>2 Rezultatet e Analizës të Kapacitetit Mbajtës Turistikë-----</b>	<b>4</b>
<b>3 Cilat rekomandime per zhvillimin turistikë te Sarandës? Planifikim strategjik dhe ekoturizëm.---</b>	<b>5</b>

## 1 Parathënie

Bregdeti jugor i Shqipërisë paraqet avantazhe të rëndësishme konkurruese nga ana turistike: një klimë e butë, një ambjent bregdetar, aktivitete turistike dhe një prodhim bujqësor i kushtuar. Rrethet përgjate bregdetit shprehin prirje të fortë për turizmin, duke përfituar vënde të reja pune, rroga më të larta, investime të reja dhe zhvillim në infrastruktura.

Për fatë të keq turizmi është edhe një konsumator i madh i pasurive natyrore (hapësire tokësore dhe sidomos bregdeti) dhe një prodhues i madh me ngarkesë të mbeturinave të ngurta dhe të lëngëshme shpesh sipër nivelit mbajtës të ekosistemit.

Aktiviteti turistik për natyrën e vet ka prirje që të konsumojë anën më të mirë të mjedisit, si për shëmbull vëndet më tërheqëse dhe të ndjeshme nga ana e pejzazhit. Ndikime shumë negative të turizmit janë vërtetuar përgjatë bregdetit shqipëtarë për shkak të urbanizimit pa kontroll i shoqëruar me zhvillimin e infrastrukturave të papërshtatshme. Kjo ka sjellë një cilësi të dobët të ujit, shndërrim i tokave bujqësore në shërbime turistike, derdhje e ujërave të pa trajtuara në det, ndotje e mjedisit për shkak të braktisjeve të mbeturinave në zona të pa kontrolluara dhe gjatë rrugëve kryesore.

Për të caktuar kufizimin e aftësisë të zhvillimit turistik të qëndrueshëm dhe e të tjerave aktiviteteve përgjatë bregdetit jonik është e domosdoshme një shikim i kompletuar të zhvillimit regjional dhe vendosje specifike mbi planifikimin dhe administrimin e turizmit.

## 2 Rezultatet e Analizës të Kapacitetit Mbajtës Turistik

Nga Analiza e Kapacitetit Mbajtës Turistik të Sarandës doli që aftësia e kapacitetit mbajtës së ambientit është element vendimtar për territorin e Sarandës.

Zhvillimi turistik i Sarandës është i “kufizuar” nga tejkalimi i kapacitetit mbajtës nga ana e ambientit të territorit të Sarandës nga njëra anë për vet turizmin dhe nga ana tjetër i pavarur nga turizmi, por që bashkë kufizojnë zhvillimin urban të qytetit.

Këto rezultate na lejojnë të pohojmë mos qëndrueshmërinë aktuale të zhvillimit turistik të Sarandës dhe domosdoshmërinë urgente ne kryerjen e veprimeve dhe investimeve në gjëndje të rivendosin një nivel të kapacitetit ambiental të qëndrueshëm.

Treguesit kryesorë që dolën nga Vlerësimi i Kapacitetit Mbajtës Turistik janë të përmbledhura në një tabelë të organizuar simbas skemës SWOT dhe që marrin parasysh të gjitha pikëpamjet e zhvillimit turistik të Sarandës të mbledhura në: pikë të forta, pikë të dobëta, mundësi, rreziqe.

<p><b>Pike të forta</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Destinacion i ri turistik</li> <li>- Bukuri të peizhazit natyror</li> <li>- Pasuri të spikatshme kulturele</li> <li>- Parku Kombëtar i Butrintit</li> <li>- Klime e butë</li> <li>- Saranda si pikë mbështetje urbane me shërbime te perparuara</li> <li>- Afërsi me tregjet kryesore të kërkesës Evropiane</li> <li>- Zbavitje (bird watching, deltaplan etj)</li> <li>- Afërsi me Korfuzin dhe Igoumenicën</li> <li>- Një bregdetet i pa prekur në pjesën verjore</li> </ul>	<p><b>Pike të dobëta</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Zhvillim urban pa kontroll në Sarandë dhe Ksamil</li> <li>- Pejzazh i komprometuar nga ndërtesat e realizuar ose në fase realizimi</li> <li>- Mungesë strategjie publike mbi planifikimin në përdorimin e tokës</li> <li>- Mungesë në pamjen e turizmit si një sektor i ekonomisë</li> <li>- Probleme me rrjetin rrugor</li> <li>- Fshatra të braktisura në zonat rurale</li> <li>- Mos përgatitje e operatorve turistikë</li> <li>- Ndikime shumë negative në mjedisin për shkak të braktisjeve të mbeturinave</li> <li>- Pjesë të bregdetit te ndotur për shkak të derdhjeve ujore pa leje</li> <li>- Vazhdime në ndërprerjen e energjisë elektrike</li> <li>- Mungesë në edukimin ambiental</li> <li>- Mungesë në lidhjen detare me Italinë</li> </ul>
<p><b>Mundësi</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Tuor operators të interesuar për të percaktuar destinacione të reja</li> <li>- Hapje të tregjeve të reja në Evropën Qëndrore</li> <li>- Zhvillim i ekoturizmit në brendesi te vendit</li> <li>- Permisim në administrimin e mjedisit të shërbimeve bregdetare me anë te përhapjes të teknologive ambientale (panale fotovoltaiço,</li> </ul>	<p><b>Rreziqe</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Kinkurim i lartë me destinacionet e tjera te mesdheut</li> <li>- Mungesë në provimin e një turizmi alternativë</li> <li>- Degjenerim i mjedisit ambiental dhe rënie e plotë e destinacionit</li> <li>- Rreziqe hidrogeologjike të shkaktuara nga ndërtimet e tepërta mbi faleza</li> </ul>

### 3 Cilat rekomandime për një zhvillim turistikë për Sarandën?

Saranda siç është theksuar shumë herë, përfaqëson një qëndër kryesore turistike e Shqipërisë jugore, zhvillimi i saj sjell pasoja në të gjithë rrethin e Vlorës. Zgjedhja e një modeli nga ana e qeverisë për këtë zhvillim është kështu çështje e rëndësishme si dhe një mbështetje e mundëshme për gjithë territorin. Në këtë kuptim, nuk mund të mos konsiderohet tendenca botërore që sheh në turizmin në masë afër një rritje të kufizuar, perkundrazi persa i perket turizmit që i drejtohet kërkesave të disa mjedisave të veçante akoma plot me prospektiva

Mbas një konfrontimi me figurat kryesorë të territorit të Sarandës mund të merren në konsideratë pikat të shënuara më poshte për një zhvillim me të qëndrueshëm të turizmit:

1. Turizmi i Sarandës duhet të mbështetet në një model cilësor dhe i qëndrueshëm në lidhje me kërkesën e mjedisit dhe të ekoturizmit, me mirëse sa në një rritje të tepert në turizmin e thjeshtë të plazhit. Ky lloj turizmi është në përgjithësi i shoqëruar me realizimin e shërbimeve turistike tradicionale dhe të rëndësishme (si për shëmbull hotelet përpara bregdetit) me ndikime shumë të rënda në mjedisin dhe në peizazh.
2. Planifikimi i përdorimit të tokës duhet të bazohet në një analizë me të kujdeshme për nevojimet e të ardhmes, me pjesëmarrjen e të gjithë stakeholderëve (me aktivizimin e proceseve pjesëmarrëse) duke përfshirë edhe turistët për të identifikuar edhe kërkesat e turistit të huaj.
3. Zgjedhja e një zhvillimi ekonomik i mbështetur mbi turizmin duhet patjetër të sjellë një model administrimi që të përcaktojë, të ruajë e të vlerësojë pasuritë kulturore dhe ambientale si vete premise të zhvillimit ekonomik.
4. Në mënyrë të veçantë duhet të zbatohen veprimet e shënuara më poshtë për administrimin e mjedisit për rrethin e Sarandës: një plan i plotë për administrimin e mbeturinave urbane, për monitorimin e pasurive ujore (duke bashkuar aspektet e kursimit të ujit me ato të administrimit të braktisjeve), plan për administrimin e harxhimit të energjisë, për monitorimin e cilësisë së ujit detar, etj.;
5. Është e rëndësishme përcaktimi i një plani për zhvillimin urbanistikë dhe që të konsiderojë kërkesat për hapësira të reja publike dhe për infrastrukture të përshtatshme me rritjen e madhe e ndërtesave me banimeve të verifikuara në vitet e fundit. Ky planifikim duhet të garantojë një studim të plotë me integrimin e aspekteve morfologjike të territorit të Sarandës duke krijuar kështu një sistemë mbështetëse për zhvillimin turistikë të qëndrueshëm.
6. Për të sjellë Shqipërinë në mënyrë graduale në rrethin e turizmit botëror duket e domosdoshme si fillim të pikë synohen zonat më atraktive dhe rekreative dhe të lidhura sa më mirë me rrugët kryesore. Nga kjo anë Saranda dhe Ksamili paraqesin për vendosjen që kanë dhe për pasuritë historike dhe të pejzazhit një rëndësi strategjike dhe që mund të tërheqin me vete të gjithë turizmin shqiptarë.
7. Edhe duke para parasysh një ndarje të pasurisë dhe një rritje të shpresave gënjë ana e popullsisë është e rëndësishme aktivimi në brendësi të tokës të disa rrethave ekonomike më përpara akoma se sa turistike të lidhura me prodhimet bujqësore të vendit si mbështetje për turizmin bregdetarë.

8. Është e rëndësishme përcaktimi i një master plan dhe e disa masave të menjëhershme për mbrojtjen e ambjentit, për sistemimin e zhvillimit të ndertimit që vazhdon dhe përmbartja/administrimi i ndertimeve pa leje. Në këtë mënyrë duke konsideruar situatën aktuale dhe të prirjes e rritjes së ndertimeve pa leje duket e rëndësishme që të bëhen disa kritere të qarta të pranimit/mos pranimit për një valutim të urbanizimit pa leje.

9. Në qoftëse ekoturizmi paraqet një parasynim për qëndrueshmërinë dhe cilësinë gjithashtu edhe një investim i pa diskutuar për të ardhmen ekonomike e turistike të Shqipërisë, koherat nuk duken akoma të pjekura për realizimin e plotë të tijë. Nga kjo pikëpamje është e rëndësishme aktivimi i projekteve për të mbështetur turizmin shqiptarë dhe politika seriose për një edukim ambjental. Qëllimi është që të përhapet një ndërgjegje që përveç anës moraliste akoma pak e kuptuar dhe e mbështetur nga operatorët shqiptarë, ruajtja e ambjentit dhe format e turizmit të qëndrueshëm janë në periudhën e mesme- të gjatë një burim pasurie dhe mirëqenie.